

IX

**MBLEDHJA E KUVENDIT MBAJTUR ME 4.7.2002**

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI**

Parlamenti i Kosovës për më pak se 7 muaj pësoi dy humbje të mëdha, humbjen e dy deputetëve, Dje ka ndërruar jetë deputeti i Parlamentit të Kosovës z. Bedrush Çallaku. Është një humbje për tërë Kosovën për familjen dhe Parlamentin në veçanti. Prandaj e nderuara familje Çollaku, të nderuar deputetë më lejoni që t'ju ftoj me një minutë heshtje t'i bëjmë nderime z.Çallaku.

Një minutë heshtje,

Për rrugën jetësore, veprën e madhe, për realizimin e të drejtës së një populli, të familjes dhe individuale të tij do të na thotë një fjalë bashkudhëtari i një pjese të rugëtimit të deputetit të nderuar, z. Kosumi e të njejtën kohë do ta lexojnë telegramin e gjeneralit Agim Çekut që ia ka dërguar Parlamentit. Falën e ka z. Kosumi,

**BAJRAM KOSUMI**

E nderuara familje e Bedrush Çallakut, i nderuari kryetar i Parlamentit, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës. Para mbajtjes së seancës së sotme të Kuvendit të Kosovës, Kuvendi po mban mbledhje komemorative për vdekjen e deputetit të këtij Kuvendi, zotëri Bedrush Çollaku. Kolegu ynë, zotëro Çollaku, pas një sëmundje të rëndë vdiq dje në orët e herëshme të mëngjesit. Ne sot shprehim pikëllimin e madh për vdekjen e hershme të kolegut, patriotit, të mikut dhe njeriut i cili tërë jetën ia kushtoi një ideali, çlirimit të Kosovës. Bedrush Çallaku u lind më 1940 në Prizren, ai u lind në një familje hasiane, me traditë atdhetarie, e cila gjatë shekujve kurrë nuk iu nënshtrua pushtuesit osman, serb, e fashist. Kjo traditë e fortë patriotike, ishte djepi i krijimit të personalitetit të tij patriotik dhe politik. Ai gjatë jetës së tij do të ndjekë këtë rrugë, asnjëherë nuk do të pajtohet me pushtimin e Kosovës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin Ekonomik në Prishtinë. Në fillim të viteve 60-ta zhvillon aktivitet në grupet e fshehta patriotike. Në vitin 1964 arrestohet nga regjimi serb, dhe 5 vjet mbahet në burgun e Nishit. Pos këtij dënimi ai do të arrestohet edhe do të mbahet më shkurt në burg edhe 2 herë, një herë në vitin 1979 dhe herën tjetër në vitin 1981.

Pas viteve 90-të ai ishte njeri nga udhëheqësit e lartë të partisë parlamentare të Kosovës, pastaj ishte veprimtari i lëvizjes popullore të Kosovës i angazhuar për ta ndihmuar zgjerimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërsa pos luftës ishte njëri ndër udhëheqësit e lartë të lëvizjes popullore të Kosovës. Në zgjedhjet parlamentare të Kosovës 2001 ai zgjedhet deputet i këtij Kuvendi. Përveç dhembjes sonë për kolegun tonë të Kuvendit z. Çollaku, ne që kemi pasur rastin ta njohim më gjatë dhe më përë së afërmi, shprehim dhembjen për mikun, dhe për bashkëveprimtarin tonë të madh i cili edhe në çastet më të vështira të Kosovës kishte guximin, vullnetin dhe mirëkuptimin pothuajse atror për ne miqtë e tij më të rinjë. Në lëvizjen patriotike në Kosovë është një numër jo i vogël i njerëzve, në biografite e të cilëve nuk mund të ndahet, një datë, një vit apo një kohë të caktuar më esenciale nga pjesa tjetër jetësore. Nuk mund ta bësh këtë, sepse tërë jeta e tyre është një angazhim i pandërprerë, i pafund dhe i pa anë, është një lëvizje e pakufishme për krijimin të lirisë. Tek ta njerëz çdo çast, e çdo ditë dhe çdo kohë janë esenciale në krijimin e lirisë.

E tërë nga ana e tyre jetësore është një vrull lirie. Në mesin e këtyre krijuesve të lirisë është edhe Bedrush Çollaku. Ai bëri vepra të mëdha dhe të vogla për Kosovën, mbajti gjallë shpirtin e lirisë së Kosovës, mësoi nxënësit e Kosovës, punoi kudo nëpër Kosovë, mbajti burg për Kosovën, ndihmoi luftën e Kosovës, ndihmoi gjysmë – lirinë e Kosovës, me një fjalë bëri atë që mund ta bënte vetm ai njeri që ka vendosur të jetojë i lirë. Besoj fuqimisht se fakti që në institucionin ligjdhënës të Kosovës, në Kuvend po jipet lamtumira e fundit z. Bedrush Çollakut është një dëshmi e fortë se në Kosovë është krijuar një themel i sigurtë mbi të cilin ajo dhe populli i saj do ta zgjidhë njëherë e mirë fatin e saj të lirisë. Për këtë ka punuar mbi 40 vjet edhe deputeti i këtij Kuvendi zotëri Bedrush Çollaku., Prandaj ai edhe do të jetë pjesë e pandashme e lirisë së Kosovës. Lavdi jetës dhe veprës së tij.

Do ta lexoj edhe telegramin që ka dërguar gjenerali lejtnant Agim Çeku, komandant i TMK-së.

I nderuar kryetar i Parlamentit të Kosovës, të nderuar deputetë,  
Duke bashkëndjerë me të gjithë ju dhembjen për vdekjen e deputetit të nderuar të Parlamentit të Kosovës, z.Bedrush Çollaku, më lejoni që me anë të këtij telegrami, t'ju shprehu ngushllimet e mia më të sinqerta, në emrin tim personal por edhe në emër të të gjithë officerëve dhe ushtarëve të Kosovës. Me vdekjen e Bedrush Çollakut, i cili ka lënë pas vetes një vepër të denjë për respekt, Parlamenti i Kosovës, do të jetë më i varfur për një zë trimi, i cili gjithmonë është ngritur kundër padrejtësive, ndërsa Kosova ka mbetur pa një zë burrëror që e ka bërë atë shpirtërisht dhe moralisht më të fuqishëm. Ndonëse vdekja e parakohëshme nuk e la idealin ta realizonte deri në fund për cilin ishte përpjekur tër jetën, unë jam thellë i bindur se ju kolegët e tij deputetët do të vazhdonin me vendosmëri rrugën për realizimin e idealit të tij dhe për të arsyetuar plotësisht besimin që ju ka dhënë populli i Kosovës. Qoftë i nderuar gjithmonë emri dhe vepra e Bedrush Çollakut. Pranoni edhe njëherë ngushllimet e mia më të sinqerta. Agim Çeku, gjeneral lejtmant, komandant i TMK-së.

#### **NEXHAT DACI**

Me kaq më lejoni ta përfundoj mbledhjen përkujtimore kushtuar Bedrush Çollakut, dhe ne do të vazhdojmë me pjesën e punës së seancës Plenare që është , në rend dite.

Për mbledhjen e sotme është propozuar ky rend i ditës;

Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, pika e dytë shqyrtimi i dytë i projektligjit nr.2002/1 mbi pensionet në Kosovë dhe caktimi i datës për fillimin e pagesës së pensionit themelor, pika e tretë , propozimi i rezolutës mbi të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre dhe mbi kushtet e kthimit të të zhvendosurve të refugjatëve, propozim që ka ardhur edhe nga Qeveria. Pyes deputetët a ka dikush ndonjë ndryshim apo aprovohet rendi i ditës. Ju falemnderit.

Kalojmë në aprovimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, Urdhëroni z. Saviq,

#### **GOJKO SAVIĆ**

Poštovani članovi Skupštine ja bih hteo samo nešto u vezi dnevnog reda na Predsedništvu Skupštine Kosova i Metohije rečeno je da će prva tačka biti usvojena iz zapisnika sa prošle sednice, zatim druga tačka razmatranje Nacrta zakona broj. 2002/1 o penzijama na

Kosovu. Za treću tačku bili smo saglasni svi da ona bude skinuta sa dnevnog reda i da treća tačka bude postavljanje pitanja. Hvala

#### **NEXHAT DACI**

Nuk qëndron as gjë e vërtetë që tha deputeti, prandaj procedojmë me rendin e ditës që e aprovuem, aprovimi i procesverbalit a ka , urdhëroni,

(serbisht nje femer nuk e keni tregu emrin)

Niste me videli ja sam htela oko dnevnog reda ja bih tražila odlaganje ove tačke obzirom nijedan poslanik od koalicije Povratak nij dobio materijal samog predloga tako da nemožemo da učestvujemo i oko razmatranja samog predloga, )nismo dobili materijal.

#### **NEXHAT DACI**

Unë po kërkoj falje një pjesë e deputetëve fare ose nuk janë të pranishëm. Më tepër se dy muaj ka se ky material është shpërndarë. Këtë material e ka patur edhe Komisioni i Parlamentit për komunitet e kryetari i atij komisioni është një anëtar, një deputet nga kualicioni serb „Kthimi”. Ai deputet më ka njohtuar mu në mbledhje me kryetarë të komisioneve që komisioni e ka shqyrtuar dhe e ka përkrahur, prandaj ju lutem, lus edhe anëtarin e Kryesisë edhe deputetin që herave tjera le t'i shqyrtojnë mirë materialet, prandaj le të paraqiten. A ka dikush lidhur me procesverbalin?, Urdhëroni

#### **SABIT RUSTEMI**

E nderuara Kryesi, Kryetari i Kuvendit dhe deputetë,

Në seancën e kaluar nën çështje të ndryshme, unë pata shtruar një pyetje se a ka pregaditur diçka Kryesia e Kuvendit të Kosovës për 2 korrikun për shënimin e 12 vjetorit të deklaratës Kushtetuese, me që as atëherë nuk mora përgjigje, kisha pasur dëshirë që ajo projekt pyetje e imja të përfshihet në procesverbal sepse në këtë proces verbal mungon. Prandaj e thirrë për shkaqe simbolike ju themë edhe njëherë kërkoj që ajo pyetje të përfshihet në procesverbalin e seancës së kaluar të Kuvendit. Ju falemnderit

## **NEXHAT DACI**

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës shqyrtimi i dytë i projektligjit nr. 2002/1 mbi pensionet në Kosovë. Para se të kalojmë në debat dhe në aprovim më lejoni që të bëni një lutje, meqë në mbledhjen e seancës së kaluar ishin dikund 30 diskutant kësaj radhe t'ju japim përparësi atyre që nuk patën shansë,

Ju e dini në këtë projektligj ose ligj që nuk janë të përfshirë të gjithë strukturat ose gjithë nga ana e nevojëtarëve për këtë ndihmë sociale ose pension të pleqërisë. Nuk jam shumë i adhures i asaj ligji mbi pensionet por ne duhet si të tillë ta trajtojmë. Unë nuk pata rast që ta kem tërësinë e Kryesisë sot në mëngjes. Dje kam diskutuar edhe me kryeministrin e mendoj që ka përkrahjen absolute që sot të nxjerrim një vendim krahas aprovimit të projektligjit, një vendim që kërkohet edhe invalidët të përfshihen në këtë ligj, ndërsa formën e mënyrën lë ta formulojë Qeveria dhe Ministria përkatëse një llojë forme mendoj se është pëlqyer është propozuar si alternativë nga anëtari i Kryesisë së Kuvendit profesor i fakultetit juridik z. Fatmir Sejdiu megjithatë unë jam adhures që forma definitive t'i lihet propozuesit do të thotë Qeverisë dhe Ministrisë përkatëse, prandaj nuk e shof të arsyeshme që të hapim debatet e nxehta për arsyeshmërinë ose mosarsyeshmërinë në qoftëse ka ndonjë propozim që ta begatonte këtë projektligj ose këtë ligj atëherë e hapi debatin. Kush është i interesuar të diskutojë, urdhëroni, ministri Ali Sadriu,

## **ALI SADRIA**

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, ju falenderoj për lejën tuaj që t'ju drejtohem.

Ne për së afërmi kemi vëzhguar diskutimin mbi projektligjin gjatë seancës së parë të Kuvendit dhe në mënyrë të kujdesshme kemi shqyrtuar komentet dhe rekomandimet e Kuvendit dhe të Komisionit kryesor relevant të Kuvendit për këtë çështje.

Ju lutem më lejoni që në këtë prezentim timin t'ju përgjigjem rreth disa brengave kryesore që dalin gjatë diskutimit.

Ligji mbi pensionin themelor është ligji i parë që do të shqyrtohet nga ky organ që nga fillimi i hapave të parë drejtë demokracisë që rrjedhin nga autoriteti i popullit të Kosovës.

Që nga viti 1999 të moshuarit në Kosovë nuk kanë marrë pensione. Kështu themelimi i një sistemi të ri pensional në Kosovë ka qenë një nga prioritetet më të larta politike, në procesin e zhvillimit të konceptit për sistemin e ri pensional kemi principet në vazhdim, arsimimi i interesave komplekse të të gjithë grupeve popullore, krijimi i ni sistemi pensional i cili mbulon gjithë popullsinë, i bilancit buxhetor afatshkurtër dhe afatgjatë, Krijimi i lidhjes ndërmjet kontributeve pensionale dhe përfitimet nga pensionet, promovimi i zhvillimit makroekonomik, rregullorja mbi pensionin nr. 2001/35 është nënshkruar dhe ka vendos 3 çështje kryesore: ka prezentuar përfitimin universal për të gjithë të moshuarit për të gjithë kosovarët që kanë mbi 65-vjet, ka prezentuar komponentën e re të financimit të sistemit pensional për punonjësit e tanishëm, ka afruar bazën ligjore për sistemin vullnetar pensional. Kjo rregullore ka krijuar një korniz të përgjithshme të pensionit themelor në Kosovë, sidoqoftë nuk ka specifikuar nivelin preciz të përfitimeve dhe as nuk ka vendosur datën e fillimit të pagesave, këto vendime të rëndësishme janë lënë Kuvendit të Kosovës.

Është bërë në zgjidhje fundamentale që pensionet t'u jipen të gjithë kosovarëve që kanë moshën mbi 65 vjet dhe me asnjë kusht tjetër dhe jo që ky pension tu jipet një pjesë të vogël të moshuarve siç ka qenë më parë. Përfitimi nga pensioni themelor do të jetë universal, niveli i njejtë për të gjithë ata që janë mbi moshën 65 vjeçe. Është e rëndësishme të njihen të gjithë të moshuarit, të cilët kanë vuajtur aq shumë në vitet e vështira të shekullit të kaluar.

Ne i njohim ata pa marrë parasysh punësimin e tyre apo kontributet e mëparshme, sepse shumë nga ata me anë të praktikave diskriminuese kanë qenë të parandaluar për të ndjekur format normale të jetës së tyre në punë dhe në jetë.

Në të ardhmen do të jetë e rëndësishme që të theksohet nevojat e atyre që kanë kontribuar në sistemin e vjetër, por do të ishte e papranueshme të pritët deri sa të ket zgjidhje çështjet komplekse siç janë ato politike dhe administrative, ku në anën tjetër sot mund t'ju përgjigjet nevoja sadopak minimale, por që janë shumë urgjente të popullatës së moshuar. Sistemi universal dmth mu pak para, por të përfshihen të gjithë pensionistët e jo

pensione më të larta për një pjesë të vogël të moshuarve. Rekomandimi i Kuvendit ndaj Qeverisë ka qenë shqyrtimi i nivelit të përfitimit dhe kërkimi i mundësive për ta rritur atë. Më lejoni t'përmendi së pari: ne duhet të mësojmë së pari se si duhet të marrim vendime të vështira, dhe si të përgjigjemi në mënyrë adekuate ndaj nevojave për të gjitha grupet e popullatës. Rritja e shpenzimeve në pensione do të zvogëlojë resuret në disponim për financimin e shkollave, spitaleve, rrugëve, ndërtimeve dhe shumë programeve tjera të domosdoshme për ndërtimin e infrastrukturës së re të Kosovës, e cila është shumë e domosdoshme.

Jemi të kufizuar me një buxhet të vogël për të njohur dinjitetin dhe kontributin e gjeneratave që kanë kaluar para nesh, edhe më përfitimin e prej 28 eurove sa figuron si projekson, ne jemi duke dedikuar 13% nga buxheti vjetor gjegjësisht  $\frac{1}{4}$  nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, por poashtu është e shumë e rëndësishme se disa resure të lidhura për shoqërinë tonë dhe për nevojat tjera të cilat duhet të financohen nga të njëjtat resure buxhetore dispozicion që është rasti i dëmtimit nga tërmeti në regjionin e Gjilanit dhe sfidat tjera që kishim dhe mund të presim në të ardhmen, përfitimi për 28 euro është propozim vetëm për 6 muajt aktual të këtij viti, është i kufizuar, por nuk kufizon limitin për përcaktimin e nivelit të vitit 2003.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave do të zhvillojë strukturë të shportës së konsumit minimal të bazuar në boston e saj do të propozoj për fitimet për vitin 2003. Derisa ne nuk jemi duke propozuar asnjë numër specifik për momentin, ne jemi duke krijuar një standard të qart, i cili do të promovoj diciplinën buxhetore.

Është paraqitur edhe një propozim për të përdorur parat që vijnë si shtesë të të hyrave që këtë vit të financohen edhe pensionet themelore. Më lejoni të sçaroj që ne duhet të mendojmë në mënyrë strategjike dhe afatgjatë. Nuk është praktikë e mirë të financohet një rritje substanciale e programeve afatgjatë nga të hyrat e përkohshme dhe afatshkurtë. Nëse vendosim të shfrytëzojmë suficitin e vitit të kaluar të prezentuar në buxhet për të përcaktuar një nivel më të lartë për pensione për këtë vit, atëherë si do t'jau shpjegojmë pensionistëve vitin e ardhshëm që ne duhet t'ju zvogëlojmë nga niveli i përfitimit vjetor.

Çdo vit, gjatë procesit të buxhetit do të ketë shumë prioritete që do të konkurojnë për të njëjtat fonde buxhetore duke përfshinë këtu : arsimin, kujdesin shëndetësor dhe programet sociale e tjera që janë në radhë dhe janë urgjente për të cilat mendojmë të

reflektojmë. Pa marrëparasysh se çfarë përfitime është vendosur në vitin 2002 është e rëndësishme të sigurohemi që do të ketë resurse të mjaftueshme për ta mbajtur atë vitet e ardhshme. Nëtë njejtën kohë Qeveria do të punojë në përmirësimin e përmbushjeve së obligimeve tatimore dhe doganore, financimi prej të hyrave të përgjithshme të buxhetit të konsoliduar të Kosovës do të thotë që pensionistët do të financohen nga i tërë spektri i tatimeve në Kosovë, kështu kapaciteti i rritjes së përpilimeve drejtëpërdrejtë do të jetë i lidhur me përmasat e ekonomisë dhe me rritjen e ekonomisë dhe me përmbushjen e përmasave tatimore dhe të hyrave buxhetore do të rritet edhe shkolla e përfitimeve gjithashtu do të përcjellë këtë rritje.

Në fund dua ta adresoj çështjen e programeve tjera që nuk mund të përfshihen në ligjin e tanishëm, ne pranojmë që ekziston një numër çështjesh tjera të rëndësishme politike dhe relacionin në ofrimin e sigurisë për grupet e pambrojtura në mënyrë sociale të popullatës së Kosovës dhe Qeveria është e përcaktuar që t'i adresojë ato në të ardhmen. Ndërkohë ekziston një numër i programeve që vazhdojnë të financohen nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe të administrohej nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, sistemi pensional invalidor, i invalidëve të luftës është tanimë në një çështje operationale, në një periudhë prej disa muajsh janë duke përfituar për invalidët e luftës dhe për të afërmit e tyre që kanë dedikuar. Kuptojmë nivelin e tregimit të tij dhe është brenga e shqyrtimit për ne. Poashtu familjet e varfëra dhe me një anëtar invalid të tyre kanë të drejtë të marrin pjesë në skemën e arsimit social. Jemi duke punuar dhe përpiluar një legjislacioni tjetër, i cili do t'i adresojë nevojat e pensioneve me paaftësi për punë dhe aftësi tjera të përgjithshme,

Qeveria është e përkushtuar të financoj garancën e të ardhurave minimale të cilat gjenden në varfëri të skajshme pa marrë parasysh a janë apo nuk janë i nvalid apo të moshuar.

Në përfundimë lejoni të them se reformat në pension në mënyrë specifike, pensioni themelor është në nga elementet kryesore në procesin e ndërtimit të ekonomisë së Kosovës. Popullsia e Kosovës pëson dhe shpreson shumë se ne si institucion i vet qeverisjes dhe ne të gjith jemi duke punuar që të sigurohemi që të mund t'i përgjigjemi nevojave më urgjente të shoqëris sonë. Procesi i mbledhjes së aplikacioneve për pensionet themelore tani ka filluar dhe kanë thënë se ka shumë njerëz që presin në radhë



të aplikojnë për pensionet themelore dhe që vijnë nga vendet shumë të largëta malore dhe ka shumë njerëz të moshuar ku ka dhe mbi moshën 80 –vjeçare. Deri më tani ata nuk kanë pasur një vëmendje të veçantë nga shteti. Shumë prej tyre kurrë skanë marrë pensione në të kaluarën. Qeveria është e gatshme të fillojë me një program të ri social, vendim juaj mbi aprovimi ne ligjit mbi pensionet themelore, do të jetë shumë i rëndësishëm për ata që kanë pritur për disa muaj.

Të nderuar deputetë të Kuvendit, ju lutem që sot të tregoni për kujdesin tuaj ndaj përpjekjeve të Qeverisë dhe të votoni për ligjin e propozuar. Ju faleminderit.

## **NEXHAT DACI**

Z. ministër ju falemnderit, para se t'ia jap fjalën z. Haradinaj, pastaj Flora Brovina dhe me radhë. Më lejoni vetëm një koment,

Unë e falenderoj ministrin dhe ministrat që janë të pranishëm , e falenderoj edhe për këshillën që i dha deputetëve që të marrin vendime të vështira. Të jeni të bindur z. deputetë, ky Parlament është shumë i përgatitur politikisht, profesionalisht dhe njerëzisht. Një lultje ministrave, Parlamenti kur nuk do të merrë vendime sipas asaj që do të mundohet një ministër ose ekzekutiv, dhe mos harroni se vendimet e Parlamentit janë ligj për ju për të vepruar, prandaj iu mirëkuptojmë, ju përkrahim e një Qeveri me kënaqësi e kemi krijuar e këte mos e haroni kurrë. Z. Ramush Haradinaj, ju lutem,

## **RAMUSH HARADINAJ AAK**

Z. kryetar, z. deputetë, kolegë dhe kolege,

Unë nuk do ta prezentoj fjalën time që të mos përsëris, përpos e mendoj të d'obishëm propozimin nga Qeveria për përfshirjen e invalidëve në projektligjin për pensionin themelor, dhe e mbështesim këtë që të bëhet, dhe më pastaj propozojmë, kërkojmë që Parlamenti i Kosovës sot krahas mbështetjes, pra aprovimit të ligjit për pensionet themelore, i cili mbështet qytetarët e Kosovës të moshës mbi 65 vjeç ku do të përfshihen në bazë të kësaj që u tha edhe invalidët e punës të merr vendim dhe të kërkojë nga

Qeveria e Kosovës, nga Administrata e Unmikut që të inicojë pra që të përegadisë projektligjin i cili do të zgjidhë çështjen e pensioneve të punës dhe pensionet familjare. Pra që të vendosim sot që poashtu e fillojmë me inicimin, pra me hartimin e ligjit i cili në një mënyrë do të zgjidhë ato çështje që nuk janë zgjedhur meqenëse edhe ne dhe besoj që të gjithë pajtohemi se e drejta në pension është e drejtë themelore e cila ka qenë e rregulluar me ligje në Kosovë dhe poashtu është e rregulluar edhe në konventat europiane dhe ato ndërkombëtare, pra ne duhet të shënojmë, të shkojmë ma tutje. Kjo do të kërkoj nga ne edhe kërkimin e fondit të marrur nga Serbia, pra të fondit të pensioneve dhe kësisoji edhe hulumtim për burimet tjera financiare, në mënyrë që projektligji që do të hartohet të mund të sigurojë edhe mbështetje.

Jemi në dijeni për mundësitë e limituara në buxhetin e Kosovës sidomos në këtë vit, meqenëse e dimë sikur ky buxhet është hartuar vitin që shkoi, megjithatë ne mendojmë: që shuma bazë duhet të shqyrtohet. Duhet të shqyrtohen edhe mundësitë e rritjes në vazhdim të kësaj shume në rrast të rrethanave tjera ose më të favorshme, pra në raste të hyrave të tjera në buxhetin e Kosovës. Poashtu, propozoj ose kërkojmë që Parlamenti të vendosë që krahas hartimit apo të kërkesës së hartimit e ligjit për pensionet e punës dhe atyre familjare të zgjidhet me ligj edhe pozita e invalidëve të luftës të UÇK-vës, pra jo vetëm një asistencë, një ndihmë apo një çasje sikurse e deritashme, por pozicioni i invalidve të luftës të përcaktohet me ligj, të veprohet kësisoji me pozitën e familjeve të dëshmorve, pra të qartësohet pozita e tyre është obligim ynë, të vazhdojmë më tutje sidomos me fëmijët që kanë mbetur pa dy prindër. dmth. kemi fëmijë jetimë në Kosovë, por ndoshta do të ishte mirë që ne të marrim një vendim për këtë çështje dhe që të mos bëhem i tepërt jemi në dijeni, ne kemi obligime ndaj të hendikepuarve, në Kosovë ka shumë, janë 80.000 shifra që janë dhënë, pra të qartësojmë edhe këtë çështje dhe të marrim qëndrim rreth kësaj çështje se si do të sillemi ne ndaj tyre edhe do të vazhdoja më tutje i kemi edhe të verbërit pastaj kemi të shurdhërit por kemi kategoria qytetarësh që e presin mbështetjen e presin një çasje nga ana jonë,

Si grup parlamentar kam të drejtën të flas në emër të kolegëve të mij, meqë kryetar i grupit parlamentar është jashtë vendit. Ne kërkojmë që sot të mbështetet, të arrovohet projektligji në propozim, i cili sikurse kanë mbështetur qytetarët mbi moshën 65 vjeç, që tani përfshinë edhe invalidët e punës dhe të marrin vendim për fillimin e hartimit të ligjit,

që do të zgjidhë çështjen të pensionit të punës, pensionet familjare dhe çështjet që i ceka me radhë. Ju falemnderit.

## **NEXHAT DACI**

Zoja Brovina e ka fjalën pastaj z. Hamiti, ju lutem

E mbështes ligjin mbi pensionet ose bazën për pensione sepse është një ligj pozitiv i cili për herë të parë i mbron disa kategori që kurrë s'kanë qenë të mbrojtura dhe atë pleqtë mbi moshën 65 vjeçare. Në këtë kategori hynë edhe gratë të cilat kurrë s'kanë punuar. Kjo është shumë pozitive dhe besoj se nga kjo mund të nisemi. Mëgjithate, nuk mund të pajtohem që në këtë ligj nuk janë të përfshirë edhe invalidët e punës, dhe krahas këtij ligji nuk u nxorë edhe ligji i cili do të përfshinte invalidët e Luftës Çlirimtare dmth. UÇK-së, familjet e dëshmorëve dhe të të zhdukurve.

Sa i përket bazës 28 euro me këtë nuk kam mundur të pajtohem, sepse kjo bazë nuk siguron as minimumin dhe është ca ofenduese. Ajo nuk e plotëson kërkesën që të realizohen 2.2100 kalori në muaj. kjo s'ka asnjëfarë logjike dhe kam bërë pyetje nga këshilltarët në Komision, pra për çështjet sociale -cila është shuma për 2.200 kalori që të mund të kemi logjikën sa kushtojnë 2.100 kalori. Unë e di se buxheti jonë është aq sa është dhe nuk ka pasur mundësi të sigurojë më tepër, megjithatë, aty e kemi shtrënguar plotësisht rrypin që kësaj kategorie t'i sigurojmë diçka që është normale, besoj se jo. Nëse arsyetimi qëndron se të hollat na duhen sepse na duhen, në shëndetësi, unë po them këtu ekziston një cipë kombiciozus- sepse kjo kategori gjithnjë ka nevojë për mbrojtje shëndetësore dhe do t'i harxhojë më së shumti të hollat në shëndetësi, nëse nuk e ka bazën materiale dhe tek e fundit me këto të holla as nuk mund t'i sigurojë barnat, prandaj ne do të nxjerrim domosdo gjatë këtij viti një ligj që këtyre t'iu sigurojmë barnat falas. Atëherë të hollat prapë harxhohen. Gjithashtu idea se pensionet përveç në shëndetësi dmth. kët pensionistë, ky buxhet suficit nuk mund të harxhohet, sepse duhet për çështjet tjera, nuk mund të pajtohem për arsye se është hera e parë pas 3 vitesh që këtyre uipet një sumë as simbolike dhe unë kërkoj nga ministri për financa edhe një përgjegje:

Cila është mundësia e fundit që këtyre pensionistve t'iu shtojmë? A ndërsa në ligj kërkoj që të hiqet vlera 28 euro sepse s'ka kurrëfarë kuptimi. Le të ekzistojë 2.100 kalori dhe arsyetimi i Qeverisë ose i Ministrisë pse nuk ka mundësi për ta plotësuar shumën e eurove që kushton 2.100 kalori? Falemnderit.

### **SABRI HAMITI**

Unë kam dëgjuar bisedat që janë bërë për këtë ligj në seancën e kaluar dhe në këtë dhe ajo që e bënë më të kapshëm për votim tashti është propozimi i kryetarit të Kuvendit që në këtë që ne po e quajmë pension themelor të të hyjnë edhe invalidët. Un kujtoj që janë krijuar të gjitha kushtet që një variantë e propozuar të vijë kah fundi dhe të votohet sot këtu. E kamë një propozim që Kuvendi mos të marrë një vendim të veçantë se nuk ka nevojë, po vetëm në paragrafin e parë të nenit të parë atje të shtohet ku thuhet, të drejtë të gëzimit të pensionit themelorë kanë të gjithë qytetarët e Kosovës të cilët e kanë mbushur moshën 65 vjeçare dhe invalidët. Pa kurrëfarë vendimi, unë i thërrasë deputetët e Lidhjes Demoraktike të Kosovës në Kuvendin e Kosovës që ta votojnë sa më shpejtë këtë ligj, në mënyrë që të fillojë zbatimi sa më parë i tij, natyrisht duke i mbështetur kërkesat e diskutimeve që të mos jetë e fiksuar në ligj shuma ekzistuese. Ju falemnderit

### **NEXHAT DACI**

Liljana Keniq pastaj Stojanka .. pas kësaj

### **LILJANA KENIĆ**

Poštovani kolege poslanici, koalicija „Povratak“ i na prošloj sednici je predložila i sada predlaže izmene i dopune amandmana na predloženi Nacrt zakona više u formalnom smislu nego suštinski .

Ja bih pročitala kompletan tekst sa izmenama i dopunama koje je predložila koalicija „Povratak“, Dakle, opšte odredbe člana 1 o vim zakonom uređuje osnovno penzijsko osiguranje uslove i način ostvarivanja prava na osnovna penzijska osiguranja datum početka ostvarivanja prava i metod određivanja visine osnovne penzije. Osnova penzijskog osiguranja u smislu ovog zakona, predstavlja poseban vid penzijskog

osiguranja zasnovan na zaštiti na obezbeđenje minimum materijalne i socijalne sigurnosti osiguranika i korisnika osnovnog penzijskog osiguranja.

Član 2 Status osiguranika iz osnovnog penzijskog osiguranja u smislu ovog zakona stiče svako lice starije od 65 godina registrovano pri UNMIK-u kao građanin Kosova i Metohije, dakle lica nastanjena na Kosmetu izbegla i raseljena lica sa Kosova i Metohije sa ličnom kartom ili potvrdom o registraciji. Član 3. Osiguranici koji ispunjavaju uslove iz člana 2 ovog zakona i koji su se prijavili penzijskoj administraciji Kosova do 31 oktobra 2002, biće isplaćeni od dana prijavljivanja. Osiguranici koji ispunjavaju uslove iz člana 2 ovog zakona i koji su se prijavili penzijskoj administraciji Kosova posle 31 oktobra 2002 godine biće isplaćeni od početka meseca u kojem su se prijavili.

Član 4. Osnovna penzija za 2002 god. utvrđuje se mesečnim novčanim iznosom u visini od 28 eura, koja saglasno međunarodnim standardima zadovoljava minimum materijalnog obezbeđenja osiguranika. Usklađivanje osnove penzije vršiće se jednom godišnje na osnovu podataka o indeksu rasta troškova života objavljenih od organa nadležnih za poslove statistike i realnih mogućnosti Kosovskog budžeta.

Obavezuje se ministarstvo finansija i ekonomije da najkasnije do 01.12 svake godine pripremi procenu potrebnih sredstava osnovog penzionog fonda saglasno merilima predviđenim u stavu 2 ovog člana. Budžetom utvrđeni nivo fonda za osnovno penzijsko osiguranje neće biti manjan tokom godine. Visina osnovne penzije za narednu godine ne može biti manja od predviđenog iznosa u stavu 1 ovog člana. Obavezuje se ministarstvo finansije i ekonomije i Ministarstvo za rad i socijalnu zaštitu da u skladu sa ovim zakonom i uredbom 2001/35 svojim aktima konkretno ureda pitanja u oblasti osnovnog penzijskog osiguranja i da u roku od 90 dana primpreme nacrt zakona o matičnoj evidenciji osigurenika korisnika osnovnog penzijskog osiguranja; završne odredbe član 6. ostvarivanje prava na osnovno penzijsko osiguranje nije uslovljeno materijalnim položajem osigurenika i prihodima kojim osiguranik ostvaruje po drugim pravim osnovana.

Član 7. Prava ovih zakona vezana su za ličnost i ne mogu se prenositi.

Član 8. Ovaj zakon stupa na snagu danom proglašenja od strane specijalnog predstavnika generalnog sekretara a primenjivaće se retroaktivno od 1.7.2002 god. Hvala.

## **NEXHAT DACI**

Para se t'ju jap fjalën deputetëve, më lejoni që kapaciteti im durues është konsumuar për këta 7 muaj tërësisht, këte ja kam thënë në Kryesi, anëtarit të Kryesisë së Parlamentit të Kosovës z. Saviq. Në mbledhjen e fundit kam shpresuar që ai do të ndikojnë që çdo deputet në Parlamentin e Kosovës do ta respektojë Kushtetutën me të cilën është anëtar i Parlamentit të Kosovës, do ta respektojë vetëveten kurë ka marrë pjesë në zgjedhje për Kuvendin e Kosovës, do ta respektojë kontratën që e ka bërë ose vendimin që e ka nënshkruar për rrogën e deputetit, do ta respektojë ajdinë e vet që e barrtë në qafë. Në krejt këto dokumente në tri gjuhë shkuan Kuvendi i Kosovës; në anglishtë, në shqip dhe në serbishtë, prandaj deputetët të nderuar të të gjitha përbërjeve edhe politike edhe etnike, është kërkesë elementare që të silleni sipas rregullave që janë pranuar ndërkombëtarisht janë nënshkruar nga secili deputet,

Unë sot nuk do të marrë vendim do të konsultohem me këshilltarët juridikë kombëtar dhe ndërkombëtarë dhe pas kësaj mbledhje qëndrimin që do ta marrë, folëtorja nuk do t'i lejohet asnjë deputeti që t'a fyerje askend ose do t'i respektojmë normat e sjelljes ose është e drejtë demokratike e gjithëkujt të marrë pjesë ose të mos marrë pjesë, prandaj të mos përsëriten më këto, le të konsiderohet kjo seancë e fundit deri pas konsultimeve.

Dhe ta përkujtoj deputeten që komisioni i Parlamentit të Kosovës, një komision në të cilën janë përfshirë deputetët e të gjitha grupacioneve politike dhe etnike, e ka përkrahur propozimin e ligjit dhe mos të mundohet vazhdimisht që ta tensionojë situatën dhe vazhdimisht, të propozojë gjithçka që as nuk ka ardhur në Kryesi si propozim as nuk është propozim i komisionit, ne të gjithë kemi marrur pjesë dhe mos të lutemi.

## **STOJANKA PETKOVIĆ KP**

Gospodine predsjedavajući, kolege poslanici,

Ja kao, predsjednik Odbora za rad i socijalna pitanja, želim ovom prilikom da podnesem izveštaj sa sednice Odbora za rad i socijalno pitanja, i da dam neke sugestije u moje lično ime. Odbor za rad i socijalna pitanja je na svojoj IV redovnoj sednici razmatrao Nacrt zakona o metodologiji za određivanje stepena osnove penzija na Kosovu i određivanje datuma za početak provizije osnovne penzije odobrenom od Vlade na njenoj sednici 18 aprilla 2002. godine u saglasnosti se kompetencijana i odgovornostima institucija za

privremeno samoupravljanje Kosova. Na sastavku su prisustvovali i savetnik ministra za socijalno pitanja kao i savetnik ministra za finansije. Odbor je zasedao u većinskom sastavu i razmotrio naznačeno pitanje. U višečasovnoj diskusiji najveći akcent je stavljen na visinu iznosa osnova penzija od 28 eura. Većina članova Odbora smatra da je 28 eura iznos koji je ispod svakog nivoa za život koji je dostojan svakog čoveka. Kada se 28 euro podeli na 30 dana dolazi se do cifre 0,4 centa dnevno za 2100 kalorija, što ne može da podmiri ni minimalne osnovne potrebe jednog čoveka. Postavlja se pitanje: šta ne može da se kupi za 0,94 centi dnevno. Postoji mišljenje da za polaznu osnovu treba uzeti visinu cene potrošačke korpe što bi podmirilo i potrebu kupovine lekova kao i plaćanje računa za komunalije.

Visina sume kao osnovna penzija od 28 eura stvara bojazan kod članova Odbora da ne uvredimo i podcenimo naše građane onih koji su čitav svoj radni vek proveli na radu pod veoma teškim uslovima a mnogi od njih dobili trajni invaliditet. Smatramo da to nikako ne može biti nagrada za njihov rad. U Nacrtu zakona stoji obrazloženje da je to osnova od koje se polazi za ostvarivanja prava na penziju i taj iznos važi samo do kraja 2002, godine, a da će u 2003 godini biti iskristalirani kriterijumi za ostvarivanje prava na penziju koja će biti regulisana novim Zakonom o penzijskoinvalidskom osiguranju. S obzirom da na predviđen način ovom raspodelom koristimo 13% kontroliranog konsolidovanog budžeta od predviđenih 23% rashoda to znači da preostali 10% ostaje za raspodelu za pomoć siromašnima, obrazovanju, zdravstveno zaštite što će se dodatno regulisati novim zakonom koji je u pripremi. Postoji i pozitivno mišljenje Odbora da je ovim zakonom regulisano i prava žena koje nikada nisu bile u radnom odnosu.

Na osnovu celokupne diskusije prisutne situacije rashoda bužeta odbor je saglasio sledeće mišljenje. Nacrt zakona o metodologiji za određivanje stepena osnova penzija na Kosovu se prihvata u načelu sa određenom primedbom, i to:

Pod 1: da vlada Kosova u saradnji sa Ministarstvom za socijalna pitanja kao sa Ministarstvom za finansije iznađe mogućnost da se iznos osnova penzija od 28 eura poveća.

Pod 2. Da se penzioneri koji žive sami, koji se nalaze u teškoj materijalnoj situaciji oslobode plaćanja električne energije.

Kolege poslanici želim da, u svoje lično ime dam par sugestija koje su u interesu celog neophodnijeg i racionalnijeg rada prilikom ostvarivanja prava na raspodelu penzija, sto bi bilo potrebno .

Pod 1. Rešiti problem ljudi koji su se već registrovali a nisu dobili UNMIK'ovu lične kartu jer služba koja je ih registrovala ne može da nađe njihove lične karte, ili ih uopšte ne traže. Pitanje da li ti ljudi pod istim personalnim brojem treba ponovo da se fotografišu jer na ovaj način ne mogu da ostvare svoja prava.

Pod 2. Zbog geografske udaljenosti na severnom delu Kosova potrebno je otvoriti filijale u sve četiri opštine, filijale banaka, što znači Kosovska Mmitrovica, Zubin Potok Zvečan i Leposavić.

Pod 3: Da se omogući zadržavanje sredstava na računu, kako bi staračka domaćinstva mogla da podignu svoj novac u vreme kada budu u mogućnosti da dođu. Pod 4: Da sredstva može da podigne ovlašćeno lice u slučaju kada je pravi vlasnik sprečen da zbog bolesti ili nekih drugih razloga dođe i podigne svoj novac.

I sasvim na kraju dala bih još jednu ličnu sugestiju na tekst Zakona, tekst Nacrt zakona Pravilnik o penzijama, strana 1 gde piše: budžet za socijalnu zaštitu za 2001 godinu iznosio je 43,6 miliona eura što predstavlja 17% od opšteg državnog budžeta Kosova. Mislim da reč državnog treba da se zameni rečju konsolidovanog jer Kosovo još nema status države. Ono što bihtela još da naglasim je da na Odboru bilo mnogo zahteva od raznih organizacija penzhionera kao i Saveza slepih i slabovidih, da smo maksimalno razmotrili njihove zahteve i da su oni većinom opravdani i da smo ih maksimalno podžali, naravno, sve zavisi koliki je ingerencija našeg odbora. Hvala.

## **NEXHAT DACI**

Ju falemnderit për propozim të pjekur të komisionit dhe për ato sygjerime individuale, Fjalën e ka deputeti Sadudi Berisha, le të përgatitet Sylejman Çerkezi.

## **SADUDIN BERISHA**

I nderuari kryetar, të nderuarë kolegë dhe kolege,



Në seancën e shkuar të Kuvendit kishim në diskutim që është në vazhdimësi edhe në seancën e sotme pensionet themelore. Në parim e mbrojmë dhe mbështesim miratimin e këtij projektligji mbi pensionet themelore ashtu siç kërkojnë nga grupi parlamentar i LDK-së dhe kryetari i saj dhe në parim mbështesim propozimet që grupi parlamentar në krye me kryetarin për plotësimin e këtij me kërkesën për kyqje dhe të kategorisë së pensionistëve invalidorë.

Vërejtjet dhe sygjerimet që u bënë në seancën e shkuar mbi ndasinë e pensionit mbi përfshirjen e ndasisë mbi përfshirjen e kalorive etj. Konsideroj se sot besoj që të gjithë e keni para vetit propozimin e projektligjit në fjalë të bërë nga deputeti Fatmir Sejdiu që konsideroj në tërësi ka përfshirë ato vërejtje dhe vlerësimet të cilat janë bërë nga vetë deputetët në seancën e shkuar dhe në seancën e sotme, dhe ky tekst korespondon pra plotësisht me diskutimet nga seanca e shkuar, përfshinë gjitha vërejtjet dhe sygjerimet dhe siç u theksua edhe nga kryetari i grupi parlamentar për të involvuar dhe drejta e pensioneve invalidore do të shtohet fjala pensionistëve invalidor pas fjalës pensionet themelore, dhe kështu ky projekt draf ligjor ky projektligj do të përfshinte një pjesë të kategorisë së pensionistëve, nëse miratohet kështu çfarë është propozimi i z. Fatmir Sejdiu kemi me një ligj serioz, me përmbajtjen plotësisë ligjore, Përmbajtja nuk ndryshon asgjë, forma ndryshon.

#### **NEXHAT DACI**

Para se të procedojmë më lejoni ta përshëndes me që arriti në punën e seancën plenare Kryeministri i Qeverisë sonë dr. Bajram Rexhepi dhe kryeministrat. Fjalën e ka Sylejman Qerkezi, lë të përgatitet Rada Trajkoviç,

#### **ZYLEJMAN QERKEZI**

Zonja dhe zotërinj,

Në diskutimin e deritanishëm më duket sikur ne si Kuvend bëjmë pazar me Ministrinë, gjë që nuk qëndron ashtu. Të gjithë jemi në dijeni për çështjet e mundësive dhe dëshirat janë të përbashkëta. Sigurisht që unë në radhën e kaluar diskutova diçka reth çështjes se emrimit të kësaj ndihme. Unë nuk pajtohem me termin pension, me arsyetimet që i dhash në radhën e kaluar. Kësaj radhe nuk do të pajtohem në grupimin e invalidëve dhe

të pensionistëve. Mendoj se duke i radhitur arsyet e pensionistëve invalidor ata kanë nevojë për një mbështetje tjetër dhe këtë mbështetje përderisa vetë zoti i ka nda, mendoj se edhe Kuvendi duhet të bëjë një ndarje pa u nisur nga çështjet teknike, nga mundësitë të cilat janë, por ftoj Kuvendin që të mendojë dhe të votojë për ndarjen e tyre në ligj në mënyrë që mos të merremi as një kohe të shkurtër në ndarjen e invalidëve dhe të pensionistëve të ndanë në mënyrë që mundësia e rritjes së tyre të jetë në përbërje me ndarjen që i bëhet që në start, Unë për hirë të ndihmës të cilën do të jetë për pensionistët sigurisht që do të votojë për arsye se ka njerëz të tillë që presin një ndihmë sa do të vogël, por mendoj se është detyrë e Kuvendit që të merret me ndarjen e tyre ligjërisht dhe pastaj tu jpet mundësia e tyre në rritje nga shuma të cilat do të përcaktohen mundësitë përkatëse. Ju faleminderit

### **RADA TRAJKOVIČ**

Poštovani predsedniče poštovani golege poslanici.

Želim da govorim nešto što nije vezano sa ovom tačkom, ali je jako važno za ovaj parlament. Srpska koalicija Povratak želela jeda bude deo ovog Parlamenta kao što vidite i nudeći svoje amandmane na ono što pretpostavlja zakone koje ova Skupština priprema da donese demonstrira nešto što podrazumeva njeno aktivno učešće u kreiranju politike za sve ljude na ovom prostoru.

S tim u vezi, zamolila bih predsednika Skupštine da zaista svoje ponašanje uskladi sa ponašanjem koalicije Povratak u smislu konstruktivnog, tolerantnog i demokratskog ponašanja, a ne već dva zasedanja imamo incidente koji su više u funkciji diskvalifikacije poslanika koalicije, Povratak. Mi zaista, do što ste videli, prihvatili smo da budemo deo ovog Parlamenta iako je komunikacija i između nas jako teška. Tako smo danasimali problem da neki poslanici nisu bili obavesteni o nečemu što je bilo završeno na rad Odbora baš upravo zato što je sloboda kretanja za poslanike koalicije Povratak jedan veliki problem.

I nešto drugo ono što želim da vam kažem. Svi znate da poslanik Kosovsko - metohijskog parlamenta može da govori u Parlamentu otvoreno o svemu na način kako hoće i doživljava, i slobodu prava govora niko nam neće oduzeti. Tako da naziv Kosovo i Metohija za koaliciju Povratak je nešto što će se i dalje upražnjavati a želja vas da nam

omogućite da slobodno govorimo je nešto što ćemo u perspektivi videti. Ja bih volela da se na isti način borimo da svuda bude sloboda govora da svuda bude podjednako upotreba jezika. Vi odlično znate da na prostorima Kosova i Metohije gotovo sve opštine su promenile svoja imena gotovo sve ulice promenile su svoja imena, tu se uklanjaju dnevno kulturne baštine i spomenici sve ovo ustvari govori da je zo jedan etnocizam koji se permanentno prenosi na prostore Kosova i Metohije, nešto o čemu ovaj parlament treba da raspravlja. Izato, još jednom kažem, nakon ovakve odluke definitivno treba osloboditi naše govore u Parlamentu i koalicija Povratak će zauzeti svoj stav o učestvovanju u radu ovog parlamenta. Hvala lepo,

### **NEXHAT DACI**

Ju falemnderit, Unë besoj që 7 muaj kanë qenë mjaftë për demokraci mbi çdo kufi madje filluar ta merrë edhe kufijtë e anarkisë. Ju falemnderit, do të punojmë për demokraci.

### **Z. GJAVIT HALITI**

Z. kryesues të nderuar kolegë,

Kam përshtypje që mos ta zgjasim për miratimin e këtij ligji, të propozuar nga Qeveria dhe nga Ministria përkatëse sepse mendoj që janë përzi konceptet tona. Në kohën tonë, nga e kaluara komuniste, në të ardhmen të cilën po pretendojmë krejtësisht tjetër në të ngritur të Kosovës. Në qoftëse vërtet ndikohemi çdo herë nga çdo letër e cila na vjen në Parlament, nga çdo diskutim çoftë destruktiv ose konstruktiv i Parlamentit për të ndryshuar rjedhat e punimeve të këtij Parlamenti, unë mendoj se nuk do të jemi në gjendje të nxjerrim jo vetëm ligje por nuk do të jemi në gjendje të vazhdojmë punën si deputetë, si njerëz ose si kolegë, të përgjegjshëm që kemi marrë detyrat tona të përbashkëta pa marrë parasysh se i cilit nacionalitet jemi pa marrë parasysh se të cilës parti jemi. Mendoj që propozimi i Qeverisë është bërë mbi bazën e mundësive tona dhe jo mbi bazën e buxhetit të fondeve që mund të ketë Kuvajti, as Arabia Saudite as Zvicra as Suedia. Prandaj, propozoj që të miratohet duke obliguar komisionin përkatës. Qeverinë e Kosovës dhe deputetët të cilët nuk janë asnjëri të përjashtuar nga propozimet për ligje konkrete të cilët mund të anashkalojnë sh lirë edhe Qeverinë e Kosovës në

propozimet konkrete të tyre me qëllim që të pasurojmë legjislacionin e Kosovës, pastaj llogaritë ku bëhen sipas buxhetit të Kosovës, prandaj unë do të kërkoja që mos ta zgjasim me diskutimet dhe propozimet sepse unë kam për veti propozime mjaftë sepse pensioni i pleqërisë kudo në botë është i siguruar për të gjithë qytetarët dhe mendoj që iniciativa ka marrë Qeveria është e drejtë dhe të drejtat e askujt duke qenë i bindur se nuk shkelë të drejtat e nacionaliteteve dhe as invalidëve, unë nuk jam që ligjet e propozuara t'u bashkangjitet edhe ndonjë pjesë tjetër, por jam që të procedojmë në të ardhmen që të nxirret edhe ligji invalidor edhe ligji i rregullt mbi bazën e kursimeve obligative, edhe ligji i rregullt mbi bazën e kursimeve përmes sigurimeve private pse jo qysh e ka bota si dhe pensioni i garantuar i rregullt mbi bazën e kursimit të përbashkët punëdhënës, punë marrës. Kështu funksionin kjo formulë, funksionon në në kretë Evropën dhe meqenëse shumë herë e kemi gojën plotë evropë të procedojmë me miratimin e ligjeve konformë asaj që po pretendon ky ndikim. Prandaj, kërkoj edhe nga kryesia e punës, edhe nga deputetët që të kursehem nga polemikat e panevojshme që ta miratojmë ligjin në fjalë dhe të obligohemi edhe ne jo veç Qeveria se ne jemi më shumë, por mund t'i kthehemi edhe vendimeve të Qeverisë, por të lodhemi edhe ne si deputetë më pak të punojmë së bashku, të bëjmë ligjet përkatëse dhe mos të përpiqemi që ta nxjerrmi në të ardhmen çdoherë fajtor një ministri përkatëse. Ju faleminderit.

## **FATMIR LIMAJ**

I nderuar z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë,

Grupi parlamentar i PD të Kosovës, këtë lëmi e sheh si fillim të rregullimit ligjor, domethënë ligjet mbi pensionet themelore dhe normalisht që dhe jam shumë i bindur që Qeveria dhe pastaj ministrinë përkatëse do të vazhdojnë pastaj ta përmbushin me ligje konkrete për kategori të ndryshme të pensionistëve, duke filluar si ata pensionistët e punës, invalidë të punës e deri te një çështje shumë e ndjeshme dhe e rëndësishme për shoqërinë kosovare deri te invalidët e luftës familjet e dëshmorëve dhe kategoritë tjera të cilët i folën parafolësit e mij, kanë nevojë për një kujdesje institucionale Unë mendoj që dola t'ju ftojë, mendoj që ka pasur mjaftë diskutime në frymën konsultive varësisht nga çasja që është bërë që ky projektligj ta votojmë edhe definitivisht në Parlamentin e Kosovës si organin qendror duhet ta shfrytëzojmë gjithësesi dhe propagandë për

afirmime individuale dhe grupore e aq më tepër për fjalime deskrtive të cilët do të prishin edhe klimën e bashkëpunimit të Parlamentit të Kosovës, sidomos kur bëhet fjalë për kategoritë, pensionistët të cilët kanë hallet e ne ato halle i dijmë të gjithë .

Them që do të rregullohen edhe kategoritë tjera për arsye se me rregullimin e kategorisë së pensionistëve të punës dhe atyre pensioneve invalidore Qeveria e Kosovës do të ketë një argument të fuqishëm dhe të kërkojë nga Qeveria e Beogradit t'i kthejë të gjitha ato mjete të plaçkitura për vite të tëra dhe njëkohësisht do t'i rregullojë që çdo qytetarë i Kosovës duhet të ketë drejtë në një pension por jo të merr dy apo ma tepër pensione Nga vendet tjera që praktikohen sot në Kosovë, definitivisht para ligjit duhet të jenë të gjithë të barabartë, duhet të kanë të drejtat dhe gjitha obligimet.

Unë do të kursehem nga kjo pikë e rendit të ditës, sepse do të kemi edhe pika të rendit të ditës ku do të dalë në diskutim edhe me lidhjen e diskutimit të zonjës Trajkoviç, Në pikën tjetër do të diskutojmë rreth asaj çështje. Mendoj se është e rëndësishme të diskutohet edhe këtu në Parlament, Ftoj deputetët edhe të grupeve të tjera më në fund të votojnë këtë ligj dhe të kalojnë në pikat tjera të rendit të ditës. Këtu u tha që shuma nuk është reale, është një shumë shumë e vogël, po kjo duhet të fillohet, sepse ky është projektligji i parë që po kalon në Parlamentin e Kosovës dhe po fillon ndërtimin e sistemit të ri dhe ky sistem të ri dhe ky sistem i ka vështërsitë dhe problemet e veta, Shpresoj se ky Parlament kur të fillojë të debatojë për buxhetin e ri pastaj të gjejë mundësinë dhe mënyrën dhe propozimin e dhe të Qeverisë që të rritet dhe pensioni bazik, po gjithashtu të nxirren ligjet për kategoritë e pensionistëve sipas asaj që ka gjithë bota,

## **RANGJEL NOJKIĆ**

Gospodine predsedavajući ,dame i gospodo,

Mislim da se vrlo često menjaju teze kad je u pitanju koalicija Povratak i stvara se pogrešna slika, koalicije Povratak ne vrši nikakvu destrikciju i nije protiv izglasavanje ovog zakona ali mi zahtevamo da se procedura apsolutno ispoštuje i da se to proceduralno pitanje jednom se stavi na dnevni red kako treba da se vodi sednic.

Mislim,pre svega, da vi gospodine predsedavajući, niste rekli što ste trebali da kažete o onom što piše u poslovniku da li je ono prvo čitanje zakona, drugo čitanje zakona

Drugo čitanje zakona o shodno tome kako poslovnik reguliše da se mi tako ponašamo, dalje mi smo na proštoj sednici da komisija za interes i prava zajednica mora da dada i na kraju krajeva i poslovno reguliše i mora da svoje mišljenje za komisiju koja nije uopšte ni imala taj zakon na svom dnevnom redu i nije donela svoje mišljenje. Takođe, mi se trudimo da se procedura apsolutno ispoštuje, dalje, da se apsolutno ponašamo u skladu sa ustavnim okvirima i u skladu sa Rezolucijom 1244 u skladu sa drugim normativnom i mi to poštujemo ali i isto tako tražimo da i vi to poštujete. Mislim da možemo selektivno da tumačimo određena pravila i da se selektivno ponašamo prema nekim pravilima. Moramo i o no što tražimo pre svega od predsednika međunarodne zajednice.

Ustavni okvir Rezolucije 1244 zasniva se na deklaracijama o ljudskim pravima, o slobodi itd. Mislim da to treba jednom da se podeli poslanicima i da poslanici znaju šta je to kršenje ljudskih prava, a da li je to kršenje ljudskih prava ili nije, da se to poziva na osnovu određenih akata a ne na osnovu određene procene.

Takođe kršenje Poslovnika o radu Skupštine i proglašavanje destrukcijom ne može da se deklarativno to i napamet priča, nego da se jednostavno kada smatrate da je neko prekršio Poslovnik i da je nešto uradio mimo Poslovnika morate da se pozovete na postupak shodno tački ta i tog pravila, tog i tog prekršaja pravila. Mi smo trebali to i da uradimo. Mislim da moramo jednom da se uozbiljimo i da ozbiljno radimo, inače ovo i nam ne liči i ocena koja je data ovom parlamentu sve više će da potvrđuje da mi nismo sposobni da donosimo zakone i da ozbiljno radimo. Prema tome, molim vas želim da kada je u pitanju diskriminacija da ona važi za sve i da se pre svega predsednici koalicije Povratak ne diskriminišu, jer na ovaj način se krše osnovno ljudska prava. Hvala

#### **NEXHAT DACI**

Z. kryeministër a doni.

#### **IBUSH JONUZI**

Z. kryetar z. ministër dhe ministra të nderuar deputetë, ju përshëndes,

Së pari kisha filluar me diskutimin e kolegut . Mendoj se të gjithë jemi seriozë të gjithë jemi të pjekur as nuk është çëllimi i fyerjes as i nënçmimit, por i respektimit të rregullave dhe kritereve të cilat i ka ky Parlament.

Ligji për të cilin u diskutua që dy seanca mendoj që është shumë i rëndësishëm, prandaj ne përshëndesim, kurse ata të moshës mbi 65 vjeçë e mirëpresin duke e pasur parasysh se shuma prej 28 euro e kanë gjithë të qartë se është shumë simbolike dhe minimale po megjithatë po them edhe një herë ata e presin një gjë të tillë, prandaj propozoj që tu gjenden edhe forma tjera të ndihmesës sikur që është në shëndetësi në transport në udhëtim dhe në shkollim studentët e tyre e dihet forma çka ka mundësi aty dhe për fund propozoj që ata të moshës së vjetër që janë të palëvizëshëm dhe të sëmurë, administrata të krijojnë mundësi që dokumentacionin ta rregullojë në vend sepse këtë po e them prej faktit që kam pasur rast për t'i parë tha edhe ministri duke pritur në rend që nuk mundur ti përballojnë kushtet dhe rrethanat që tani janë

### **DŽEZAIR MURATI**

Dragi kolege, poštovani predsedniče i ministri,

Mi evo već u nekoliko navrata dosta pažnja posvećujemo prvom zakonu koji nam nudi ovaj forum. Kada izvršimo jedan rezime, primećujemo predloženo suma veoma simbolično. Ja bih bio možda sada u nekom centru pažnje kada bih neodmereno govorio o nekoj sumi koju je nerealna i za koje stoje takve pripreme koje su obaveza resornih ministarstava. Ovaj problem dobio je na težini i složenosti koju zaista i zaslužuje parlamentarno kako smo to do sada i činili. Ovaj parlament je u prilici već da konačno usvoji jedan zakon a možda je i veoma ne pametno nego veoma možda najadekvatniji naj realnije da smo krenuli od ove ugrožene kaegorije stanovnika. Sve se vrti oko brojke izneto je mnogo argumenata i za i protiv nje i ovde što kažu naši stari ljudi nam je toliki moralno prema njemu da pružimo noge. Ja bih samo zamolio ukoliko može u svemu ovome da se pronade neka unutrašnja rezerva, kako smo to ranije govorili, pa makar simboličnom brojkom nekako zaokružiti na 30 eura. za start. Dosadašnji diskutanti u hodu dalje treba rešavati vezano za većinu isplate penzija. Možda bi to neki poslednji naš pokušaj bio. Međutim, trebalo od nečeg krenuti a mi moramo krenuti da se ovde ne dogovaramo ako znamo koliko ljudi čeka makar i ovu simboličnu sumu o kojoj govorimo. Naravno da ja u ime grupe koju predstavljam podržavam ovaj zakon u sve primedbe koje su iznete da se u njega ugrade ukoliko je moguće i uz sugestiju da ukoliko je moguće osim ove aktivnosti koju smo pokrenuli ovde u parlamentu Kosova,

da se i na drugoj strani vode aktivnosti. Na nekoj dugoročnoj osnovi i rešavanju onih problema o kojima smo ranije govorili. Da to bude jedan dugoročni proces, ali isto tako treba možda usmeriti i dosta snaga kako pronaći možda i eventualne donatore koji bi mogli da nam pripomognu da se od ovakve skromne cene malo pomerimo ako već nemamo sami mogućnosti i ova skromna cena čini samo 13% od celokupnog bužeta pa vidite li koliko smo kratki samo.

Dakle, na kraju završavam mi prihvatamo ovaj predmet ovog zakona prihvatamo ga i molimo da se on što pre, dakle danas, pokrene i u proceduri usvoji uz sve ono što smo i do sada predlagali. Hvala.

### **NEXHAT DACI**

Unë p o m undohem që të rezimoj, Propozimi është të aprovohet ligji i propozuar nga Qeveria gjegjëse e Ministrisë përkatëse dhe nën te të inkorporohet ajo që ishte mendim i shumicës absolute që të përfshihen invalidët e punës , në të gjitha rekomandimet që u rezimuan nga të tjerët, lë të mendohet edhe për seancat tjera ose për ligjet tjera, prandaj e vë në diskutim. Kush është për aprovimin e ligjit, ju lutem, Sekretaria lë t'i numëroj mirë votat, ju lutem ,

Pyes deputetët a ka ndonjë kundër, ju lutem. Asnjë kundër. Ju faleminderit , a abstenon dikush 1,

Ju lutem të pranishëm gjatë votimit ishin 98 kanë votuar për, kundër asnjë 1 abstenoj.

Të kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. Nuk mundemi në pauzë t'ia mundësojmë kryeministrit ekspozenë, pastaj vendosim dhe shohim, ju lutem,

Pika është,

Propozimi i Rezolutës mbi të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre dhe mbi kushtet e kthimit të zhvendosurve dhe të refugjatëve. Ftoj kryeministrin z. Bajram Rexhepi,

### **BAJRAM REXHEPI,**

I nderuari kryetar, të ndëruar deputetë,



Unë nuk do t'ju marrë shumë koh. Ju Projektrezolutën te propozuar nga Qeveria e keni para jush, kjo është në kuadër të qëndrimeve të përbashkëta të institucioneve të Kosovës që gjithë qytetarët e Kosovës të kenë mundësi të barabarta të respektohen të drejtat e njeriut të mos ketë kurrëfarë lloj diskriminimi as etnik as racor as fetar të drejtën për gjithë qytetarët e Kosovës të kthehen në pronën e vetë, pra janë disa principe të cilat të gjithë ne si institucione i përkrahim për arsye se dhe jemi deklaruar se do të shkojmë drejtë demokratizimit dhe drejt arritjes së standardeve të cilat vlejné edhe në shtetet e tjera të Evropës.

Prandaj ju nëse doni në pika të shkurtëra do t'i lexoj, mirëpo e keni edhe para jush këtë Projektrezolutë poashtu menj se në një takim të mëparshëm me asociacionin e asambleve të komunave në prani të Zyrës për çështje të kthimit të UNMIK-ut po edhe të përfaqësuesve të UNHC-erit. Komisarariatit të lartë për refugjatë, i kemi aprovuar 12 principe bazë që vlejné që disa prej tyre janë të inkorporuara në këtë Projektrezolutë, ku secili do të marrë një pjesë të obligimeve që mund t'i kryejë për çështjen e kthimit dhe mendoj që është një Projektrezolutë e cila dëshmon se ne nuk e kemi qasjen vetëm në një deklaram verbal, por do të fillojmë edhe me anë të rezolutave dhe akteve tjera që t'i përbushim ato obligime që dalin para institucioneve tona. Prandaj, unë nuk do të diskutoja më gjatë, por mundësisht ta votoni këtë Rezolutë, për arsye se edhe ashtu fillimisht jemi orientuar që të shkojmë drejt demokracisë dhe jemi përkushtuar në këtë drejtim .Hvala

## **NEXHAT DACI**

### **OLIVER IVANOVIĆ KP**

Z. kryeministër, ju faleminderit z. Ivanović, e ka fjalën pastaj z. Bajram Kosumi, Poštovane kolege, ja moram da kažem da smo razgovarajući unutar koalicije, podržali principe zadovoljavaju jednu osnovnu formu, rekao bih demokratičnost i zadovoljavaju potrebe koje srpska koalicija želi da prezentira ovde.

Ja sam samo hteo da kažem da protivljenje naše ove tački dnevnog reda nije vezano za sadržaj tačke nego jednu čistu proceduru. Mi moramo naučiti i to što se zove procedura, iako ponekad u suštinu treba staviti ispred procedure, međutim ako tako nastavimo često

Doçi çemo do pozicije da onda neke bitne stvari izgubimo iz vida.

Mi danas nismo glasali uopšte o dnevnom redu, da li ste to приметili da je dnevni red stavljen kao predlog niko nije rekao ni za ni protiv, i dnevni red je išao tako. Ja znam da bi on bio usvojen. I ova tačka dnevnog reda je skinuta sa sednice predsedništva iz proceduralnih razloga. Danas je ovde na dnevnom redu, ja samo kažem još jedan put da ne shvatite pogrešno naše ideje, mi podržavamo ovakav koncept i prednost principa, ali i proceduralnog razloga smo bili protiv toga da on bude danas na razmatranja.

### **BAJRAM KOSUMI**

I nderuar kryeministër, dhe ministra, të nderuar deputetë.

Grupi jonë parlamentar e mbështetë Rezolutën që e keni Projektrezolutën që keni ofruar ju, dhe do të votojmë por në favor të kësaj dhe mendoj se kjo Rezolutë do të ndikojë në krijimin, e një shoqërie moderne në Kosovë. Ne kemi tri propozime për ndryshim të tekstit brenda Rezolutës, ju kisha lutur që të keni vëmendjen.

Pasuesi i katërt i hyrjes në Projekt-rezolutë të ndryshohet, dhe të tingëllojë kështu, të jetë kështu me leximin se shoqëria e qytetarëve të lirë e të barabartë dhe pengimi i rivendosjes së presionit ndaj çdo grupi etnik, politik apo fetar janë perspektiva e Kosovës së re demokratike. Në vend të kësaj formulimi që është këtu ekzistues. Propozim për ndryshim të tekstit është në paragrafin e pestë të tekstit të Rezolutës, fjalia hyrëse ku thuhet,, shumica e qytetarëve të Kosovës do të jetë thjeshtë qytetarët e Kosovës jo shumica po të gjithë qytetarët e Kosovës.

Poashtu, propozimi i tretë dhe i fundit është në paragrafin e shtatë këtu në paragrafin e fundit, po fjalia e fundit ku thuhet: për krijimin e një shoqërie multietnike në Kosovë, në lirinë demokratike, të ndryshohet renditja në kuptimin logjik etj. Dhe thuhet për një shoqëri të lir dhe ligjore. Dëshiroj që ta arsyetoj propozimin e parë dhe të fundit ve me një fjali: kohëve të fundit shpesh përdoret termi shoqëri multietnike është imponue nuk sështë kategori që e përcakton mirë zhvillimin e një shoqërie se mund

të ketë shoqëri multietnike që janë në luftë mes veti. Ka plot shtete që janë shoqëri multietnike, por që janë në luftë mes veti, luftojnë pa u ndalë kurrë, hiç. E ne se kemi ndërmend ta bëjmë një shoqëri të tillë multietnike, por kemi ndërmend ta bëjmë një

shoqëri qytetarëve të lirë, të barabartë, pa dhunë mbi grupet etnike, politike etj. Ju faleminderit.

## **NEXHAT DACI**

Ju faleminderit z. Kosumi, një moment ju lutem. Do të shkojmë në pauzë vetëm një fjali. Vazhdimisht ka dezinformata, në mbledhje të Kryesisë për hirë të mediave, po e them dhe ju deputetë të nderuar. Deputeti dhe anëtari i Kryesisë Saviç dhe Ivanoviç e kanë propozuar një Rezolutë që është jashtë rendit të ditës, jashtë Rezolutës të propozuar nga Qeveria. Kryesia e ka refuzuar për ta shqyrtuar në këtë seancë plenare sepse fare asnjë anëtarë i kryesisë nuk e ka pa atë dokumentë dhe ne nuk mund të vejmë. Prandaj, është hiqur prej rendit të ditës ai material, dhe jo materiali i Qeverisë dhe e dyta, ju lutem të mendoheni, ka pasur mendime shumë të çmuara të deputetëve në biseda paraprake para kësaj edhe është formuluar një propozim i këtillë që do të jetë pjesë e votimit të Rezolutës. Në zyrën e z. Shtajner duhet të jetë një anëtar, një shqiptar që do të kujdeset për kthimin e gjysmë milioni, sipas disa statistikave 900 mijë të shpërngulurve gjatë viteve të okupimit.

Parimisht është, kam biseduar është pajtuar z. Shtajner në këte. Propozimi tjetër është që në zyrën e kryeministrit dhe kjo i mbetet kryeministrit dhe Qeverisë, një shqipëtar që do të jetë në rangë të ministrit siç e ka minoriteti serb, prandaj ky propozim do të jetë pjesë e votimit të Rezolutës të cilën do ta diskutojmë pas pushimit 12.15 minutave. Pauza.

## **SABRI HAMITI**

Thash vërejtjet e mia fillojnë me titullin emrin e Rezolutës i cili propozoj të jetë mbi të drejtën dhe kushtet e kthimit të të zhvendosurve dhe refugjatëve dhe jo simpas formulimit të propozuar: Neni 5 duhet të jetë: të gjithë qytetarët e Kosovës duhet ta mirëpresin dhe të japin kontributin aktiv etj. Kemi të bëjmë me fillimin e paragrafit. Paragrafi i gjashtë dhe paragrafi i shtatë duhet të hiqen, i gjashti gjithësesi, kurse propozoj të shtohet në vend të paragrafit të shtatë një tekst që do të dukej kështu:

Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës nëpërmjet Komisionit mbi të drejtat dhe intereset e komuniteteve duhet të punojnë për krijimin e parakushteve për kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur duke shprehur përkushtimin e popullit të Kosovës për një shoqëri të lirë dhe demokratike. Pra, po rezimoj titullin, të korrigjohet, të ndreqet paragrafi i pestë, të hedhet krejt paragrafi i gjashtë dhe i shtatë dhe paragrafit gjashtë të jipet teksti që e lexova. Ju falemnderit.

## **NEXHAT DACI**

Ju falemnderit, zoti Fatmir Limaj, pastaj Fadil Kryeziu lë të bëhet gati.

## **FATMIR LIMAJ**

Zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë,

Parlamenti i Kosovës dalëngadalë po vjen para situatave dhe çështjeve jashtëzakonisht të rëndësishme drejtë ndërtimit të jetës demokratike, avansimit të procesit politik, avansim i cili duhet të shërbjë jo vetëm për qytetarët e Kosovës dhe më shërbim të qytetarëve të Kosovës, por duhet të jenë mesazhe të qarta edhe për vendet të cilat e rrethojnë Kosovën ose që janë fqinje të Kosovës.

Parlamenti i Kosovës dhe institucionet e Kosovës në vazhdimësi duhet të rikonformojnë vendosmërinë e tyre për të ndërtuar një shoqëri të lirë dhe demokratike, shoqëri e cila definitivisht do të mbrohet dhe do të jetë e barabartë para ligjit. Sipër për koicidencë sot kjo pikë shtrohet në rend të ditës kur njëherë nga vendet të cilën shembulli i demokracisë i qytetërimit, i lirisë dhe i drejtësisë sot e feston ditën e pavarsisë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës vend i cili ka promovuar aferat demokratike, të drejtën e qytetarëve, të drejtën e lirisë në të shprehur, në jetë, në punë, në përcaktimin e lirë të përkatësisë së tij etnike dhe mbi të gjitha të drejtën për t'u mbrojtur para ligjit. Duke shfrytëzuar rastin që në emër të grupit parlamentar t'ia urojmë Qeverisë dhe popullit amerikan ditën e pavarësisë, ja që edhe Parlamenti i Kosovës sot po fillon të futet në faza të rëndësishme të përcaktimit të fatit të mëtutjeshëm të qytetarëve të Kosovës. E drejta për kthimin e të gjithë atyre qytetarëve të Kosovës, të cilët në rrethana të ndryshme janë larguar nga Kosova pa vullnetin e tyre është e drejtë legjitime e pakontestueshme dhe demokratike që ne të gjithë duhet të angazhohemi t'i njohim institucionet e Kosovës, ta

njohim atë të drejtë në kthimin e çdo qytetari individual në vatrat e tyre, në pronën e tyre private. Gjithashtu, dua të shprehi keqardhje në emër të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës për veprimin që e bënë koalicioni „Kthimi” duke u larguar nga Parlamenti i Kosovës, nga kjo sallë në momentin kur ne si shumicë, në këtë rast shqiptarët, po e shprehin vullnetin tonë, përmes institucioneve, përmes deklarimeve tona që ne jemi të gatshëm për t’ju ofruar mundësi integrimin e të gjitha minoriteteve në jetën institucionale, publike e qytetare në Kosovë.

Dhe ky largim i tyre është një mesazh i keq në këtë drejtim. Shpresoj që ata definitivisht do të vetëdijsohen dhe do ta pranojnë këtë hap të sinqertë të institucioneve të Kosovës, të grupeve tona parlamentare në drejtim të ndërtimit të një shoqërie demokratike ku e kanë vendin dhe ku ne dëshirojmë që ata të jenë bashkëpjesmarrës në këtë udhëtim të drejtë dhe të domosdoshëm për të shkuar përpara.

Hapat e Qeverisë të Kosovës të bërë prej periudhës së krijimit të saj e deri më tani tregojnë qartë dhe sublimojnë vullnetin e forcave politike në Kosovë në këtë rast të Partisë Demokratike, në emër të së cilës flas unë, se ne jemi të vendosur të bëjmë hapa konkretë, ne jemi të vendosur se definitivisht tani kur na ka ardhur rasti për të shpalosur cili është vizioni ynë për të ardhmen e Kosovës t’ia themi dhe t’ua shpalosemi edhe para qytetarëve të Kosovës edhe para opinionit ndërkombëtar. Vizion i cili mbështetet në shoqërinë demokratike të lirë, mbi konceptin qytetar në kushte dhe në shansat e barabarta në këtë shoqëri demokratike për të cilën jemi angazhuar, kemi sakrifikuar dhe do të vazhdojmë të angazhohemi deri në realizimin e standardeve të përparuara të vendeve të qytetëruara.

Qeveria e Kosovës, Parlamenti i Kosovës, Presidenca, dhe institucionet tjera në nivelet lokale definitivisht duhet ta ushtrojnë autoritetin e tyre në gjithë territorin e Kosovës. Për të ushtruar këto institucione duhet të kujdesen për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim feje, përkatësin etnike, aq ma tepër përkatësi politike. Dhe hapat e Qeverisë së Kosovës ne i shohim shumë që janë duke bërë pikërisht në këtë drejtim. Ushtrimi i autoritetit të Qeverisë së Kosovës në gjithë territorin e saj përjashton absolutisht përzierjen e vendeve të tjera në territorin e Kosovës. Përjashton ata të cilët duke shfrytëzuar të drejtat të ashtu quajtura të minoriteteve dëshirojnë të përfitojnë politikisht apo të bëjnë kthim politiko-administrativ në Kosovë.

Dhe këtë jam i bindur që ne si institucione jemi duke parë , e dimë mirë dhe prandaj ne duhet të ushtrojmë autoritetin tonë në gjithë territorin e Kosovës dhe të kujdesemi për të gjithë qytetarët e Kosovës. Siguria, integrimi i pakicave kombëtare, edhe Qeveria edhe Parlamenti sot edhe një herë po e konfirmojnë qëndrimin e tyre se janë të gatshëm për integrimin e të gjitha minoriteteve në gjitha fushat e jetës në Kosovë. Janë të gatshëm me bazën dhe mundësitë, me kompetencat e tyre që kanë të ofrojnë mundësi për një jetë të lirë për gjithë qytetarët e Kosovës që janë të gatshëm në bashkëpunim me UNMIK-un, KFORIN-in dhe me institucione të tjera ndërkombëtare, të ofrojnë kushte dhe siguri për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe shanse të barabarta për ndërtimin e jetës së tyre. Dhe tani minoritetet duhet për t'i realizuar gjithë këto, duhet objektiva që ne i kemi duhet vullnet i dyanshëm.

Ata definitivisht duhet të ndërprejnë politikën e instrumentalizimit nga politikat e Beogradit. E kaluara ka treguar që sa herë se serbët e Kosovës janë manipuluar dhe instrumentalizuar nga qeveritë e Beogradit gjithmonë më së shumti kanë humbur veç serbët. Është momenti i fundit që të përcaktohen për mbështetje të përcaktohen për jetë në Kosovë dhe të përcaktohen për integrim në institucionet e Kosovës dhe për të filluar ndërtimin e jetës dhe për t'iu shërbyer interesave të qytetarëve serb të cilët janë në Kosovë, dhe jo për t'iu shërbyer politikave të ndryshme dhe të konjukturave të ndryshme në Beograd dhe në hesapet e vet Beogradit.

Të gjithë e kemi të qartë Kosova duhet të funksionoj si shtet demokratik por ky shtet aq sa ofron të drejta duhet të kemi si qytetar dhe obligime ndaj tij, aq sa kërkojmë të drejta te ky shtet aq jemi të obliguar t'i zbatojmë ligjet dhe obligimet e tjera që dalin në bazë të ligjeve para shtetit. Partia Demokratike e Kosovës e mbështet këtë Projektrezolutë dhe nuk dua të flas për atë që folëm më herët, me të vetmin qëllim për të treguar edhe një herë dhe për të bërë edhe njëhap drejt ndërtimit të shoqërisë demokratike për të bërë edhe një hap drejt avancimit të velrave njerëzore për të bërë edhe një hap drejt avancimit dhe inkorporimit të standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe mbi të drejtat e kthimit të qytetarëve në vend. Gjithashtu Partia Demokratike e Kosovës mbështet kthimin e të gjith qytetarëve të Kosovës, pa dallim etnik, në mënyrë individuale në pronat e tyre por asnjherë dhe në asni mënyrë nuk do të pranojë dhe do të angazhohet kundër përpjekjeve të kujdoqoftë për kthimin administrativo- politik të Serbisë në Kosovë, i ftoj

deputetët serb dhe qytetarët serbë të reflektojnë dhe të fillojnë të ndërtojnë një jetë të re në Kosovën e dhe demokratike, për të cilën jemi të gjithë të angazhuar dhe të heqin dorë nga ëndërrat e tyre, që nëpërmjet një grupi deputetësh në Parlamentin e Kosovës ta kthejnë serbinë në Kosovë. Ata duhet ta kenë të qartë se Serbia në Kosovë nuk ka mund të mbajë me qindra mijëra trupa policorë e aq më pak ta kthej me një grup deputetesh në koalicionet e ndryshme Kosovën edhe një herë nën administrimin e Serbisë. Kjo është diçka e kaluar që asnjëherë nuk do të kthehet, Kosova është nisur në rrugën e saj, në rrugën e lirisë dhe të pavarësisë dhe prosperitetit. Ju falemnderit,

#### **NEXHAT DACI**

Ju falemnderit, zotëriut V. Kryeziu, pastaj Ramush Haradinaj, mandej Ramadan Kelmendi.

#### **FADIL KRYEZIU**

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, unë do të jem shumë i shkurtër për arsye se Sabri Hamiti theksoi atë çka desha të them.

Në paragrafin e pestë kam përshtypjen që teksti që shkon këtu shumica e qytetarëve përgjegjësia bartet vetëm te një grup i popullatës, me një fjalë të shqiptarët ndërkaq abstetrehohet përgjegjësia dhe angazhimi që duhet të kenë vetë minoritetet për t'i realizuar të drejtat e tyre, sepse më në fund të fundit edhe kjo Rezolutë është vetëm edhe një rikonfirmim i qëndrimit të institucioneve të Kosovës, për barazi të gjithë qytetarëve të saj Kjo është edhe në Kornizën Kushtetuse edhe me ligjin që tashti në fillim që sot t'i aprovojmë, prandaj unë mbështes edhe deklarinimin e profesorit Sabri Hamiti në emër të grupit parlamentar.

#### **NEXHAT DACI**

Ju falemnderit, z. Ramush Haradinaj.

#### **RAMUSH HARADINAJ**

Dëshiroj tu jap mbështetje atyre që u thamë më përparë. Në rradhë të porë ne e mendojmë shumë me dobi këtë iniciativë të Qeverisë dhe arsyeja pse dola në foltore është

që të mbështesë propozimin e z. Sabri Hamitit për ndryshimin e titullit, emrit ky ishte një propozim shumë i qëlluar pra ishte me logjik pra që të hiqet paragrafi numër gjashtë sepse në rastë se ne e ftojmë njërin –tjetrin koalicionet e Kosovës veç e veç nuk e ka logjikën e vet pra ne mund ta ftojmë Qeverinë, ne apo presidencën me radhë mbështes poashtu propozimin që pësoi, që në paragrafin shtatë të thuhet Qeveria dhe Kuvendi apo institucionet e Kosovës në përgjithësi por jo kjo formë e adresimit reciprok se ka një kuptim sikur dikush është ma i interesum e dikush ma pak pra mbështes ato. Duke i shtue ose duke i pasë këtu propozimet që u thanë është shumë me dobi aty ku thuhet shumica të mos ekzistoj ma pra është me dobi të vetë qëllimit të kësaj Rezolutë, qytetarët e Kosovës të gjithë që jemi këtu pra e mbështesim këtë Rezolutë me këto propozime, ndryshime që u dhanë që janë në dobi të vet rezolutës pra jo si një qëllim me vonue aprovimin e saj por si një qëllim me i dhanë kësaj rezolute një përmbajtje të logjikshme e cila do të jetë me përputhje edhe me qëllimin e saj. Ju falemnderit.

#### **NEXHAT DACI**

Ju falemnderit zoti Haredinaj, lus diskutantët vetëm çështje të reja nëse kanë që të mund të kontribojnë mos..

#### **RAMADAN KELMENDI**

I nderuari kryetar të nderuar deputetë dhe ministra,  
Mendoj se kjo rezolut nga teksti i parë duhet të hjek fjalën komunitetet duke zëvendësuar me qytetarë duke u plotësuar tërësisht me vërejtjet që i thanë. Duhet miratuar këtë Rezolut edhe njiher Kuvendi i Kosovës dhe institucionet e saj legjitime përcaktojnë unionin e të gjithë qytetarëve të drejtën e kthimit të tyre, por fatkeqësisht pjesëtarët e komunitetit serb gjegjësisht minoritetit serb në këtë Kuvend pikërisht ku diskutohet kjo ata lëshojnë këtë rezolut spese këtë do ta pengojnë, dhe shembull konkret është pjesa veriore e Kosovës gjegjësisht Mitrovica veriore me 47 fshatra jo vetëm se është e bllokuar tërësisht pikërisht shumica e deputetëve serbë që ishin këtu por ata në këtë mënyrë ata bëjnë bllokimin e kësaj Rezolute. Duhet ta dimë se qytetarët e regjionit të Mitrovicës u ndalohet dhe u mohohet e drejta e kthimit në shtëpi, prona të tyre. E dyta lëvizja e qarkullimit të lirë, të gjithë udhëtojnë nëpër rrugë periferike malore për të shkuar



deri në shtëpitë e tyre, mbrojtja e drejtë shëndetësore në spitalet veriore as që mund të afrohen dhe arsimimi në të gjitha shkollat dhe në të gjitha nivelet.

Duke u bazuar në këtë unë mendoj se në pikën 1 të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim race, gjinie, feje e përkatësie etnike jo të figuriojë, kanë të drejtë t'u garantohet e drejta e kthimit sepse neve në Mitrovicë as nuk po na njihet, as nuk po na garantohet, as nuk po na mundësohet të kthemi në pronat,banesat dhe shtëpit tona dhe vetë thirrja e kësaj seance, pikërisht kur bisedohet për këtë Rezolutë është një dëm dhe në intene të mos realizimit të kësaj. Ju falemnderit.

### **NEXHAT DACI**

Ju falemnderit, zotëri Gjevdet Neziraj, lë të përegatitet Sabit Rrustemi dhe Ilaz Pireva dhe mendoj se është mjaft.

### **GJEVDET NEZIRAJ**

I nderuar zoti kryetar, zotërijë ministra dhe deputetë të nderuar.

Unë këtu po e përkrahi këtë Projektrezolutë, mirëpo do bashkangjitna disa vërejtjeve. Vërejtja e parë është që të them të drejtën fjala e dhe minoritetet fjala e dhe komunitet personalisht është duke më penguar sepse në radhë të parë e ndiej veten qytetar të Kosovës dhe qytetar të barabartë të Kosovës, prandaj andaj duhet të luftojmë, sepse edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës arritën që të bëhen shtet i demokracisë vetëm në bazë të parimit qytetar sepse edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka edhe shqiptarë amerikanë ka edhe indian- amerikanë, ka edhe arab , amerikanë dhe kanë arritur që të bëhen në të vërtet një shtet demokratik prandaj, edhe Kosova duhet ta ndjekë një rrugë të tillë.

Unë do të kisha propozuar që deri më tani edhe nga UNMIK-u edhe nga faktori ndërkombëtar disa komunitete kanë qenë ma të privileguara dhe të them këtu se asnjë komunitet nuk duhet të jrtë më qenie njerëzore sesa tjetri, po në radhë të parë duhet të jemi të barabartë, sepse deri më tani shumë fonde mjete janë ndarë ndërsa ne si komunitet shqiptaro-egjiptas jemi larguar. Prandaj, ftoj Qeverinë që të na kushtojë një kujdes ma të madh një shtyrje më pozitive në çdo aspekt,për arsye se e kemi pranuar realitetin e

Kosovës,jo tani në këtë moment po kemi qenë bashkarisht edhe më parë edhe në situata më të vështira. Ju falemnderit.

#### **NEXHAT DACI**

Ju falemnderit Sabit Rrustemi, po ju lus abstenoni ndonjeri?

#### **SABIT RRUSTEMI**

I nderuari kryesus, përkërisht desha të abstenoj në vërejtjen e fundit që u dha nga deputeti Ramadan Kelmendi por dola këtu për të shfaqur një drojë. Më herët e keni aprovuar një rezolutë të cilën z. Shtajner e ka aprovuar. Kam drojën se mos do të vepra me të kështu përndryshe do ta votojë rezolutën.

#### **NEXHAT DACI**

Ju falemnderit Ilaz Pireva, pastaj Ismajl Kurteshi , Idriz Sadiku dhe besoj se fund.

#### **ILIAZ PIREVA**

Lidhur me mendimin që do ta shpreh në këtë rezolutë më ndihimoi zoti Ramadan Kelmendi, sepse ishte e kundërthënëshme një rezolutë ku që më s' di si ta quaj ku në nenin e parë, në paragrafin e parë thotë të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim race, gjinie, feje, përkatësi etnike kanë të drejtë të gëzimit të pronës të tyre në mënyrë të ligjëshme. A bëhet fjalë për një rezolutë për kthimin e të zhvendosurve dhe të refugjatëve. Mendimi im besoj që është dhe juristët më të mirë do ta përpilonin këtë. Të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim gjinie, race, leje apo përkatëse etnike gëzojnë të drejtën e kthimit në pronat e tyre ligjore të paluajtëshme e pastaj le të vazhdojë me pasuesin tjetër, Ju falemnderit.

#### **NEXHAT DACI**

Ju falemnderit Ismail Kurteshi

## **ISMAIL KURTESHI**

Faleminderit, meqë sot po bisedojmë për problemin e refugjatëve unë desha t'ë ju përkujtojë juve kolegë të nderuar se ekziston edhe një problem tjetër për të cilën s'është bërë fjalë dhe ndoshta do ta vlerësojmë se në këtë rezultat a mund të futet një pikë? Në komunën e Gjilanit por besoj edhe në komunat tjera ka plot shqiptarë të Preshevës Bujanovcit, Medvegjës dhe të Maqedonisë, të cilët nuk mund të kthehen në shtëpit e tyre për shkak të pengesave administrative të krijuara nga këto dy vendet, prandaj ndoshta do të ishte mirë me një pikë atje të përmendet se institucionet e Kosovës do të angazhohen që shqiptarët e këtyre trojeve, të cilat i përmenda t'u mundësohet kthimi nëpër shtëpit e tyre. Ju faleminderit.

## **NEXHAT DACI**

Ju faleminderit Sadik Idrizi më falni.,

## **SADIK IDRIZI**

Mislim da ćemo i mi podržati ovu rezoluciju jer se upravo ide u pravcu da se vrata raseljeni.

Zajednica kojoj pripadam je zajednica koja je dovoljno integrisana i neke stavi idu mislim napred. Što se tiče kretanja, sloboda govora i tako dalje, zaista ima napretka ali to treba da važi za sve i mi ćemo podržati ovu rezoluciju. Prvi član ovde koji je dat i govori o pravu svoje privatne imovine mi smo prilikom usvajanje programa vlade pokrenuli pitanje da je pripadnicima naše zajednice koliko je evidentirano oko 90 lokala na Kosovu je oduzeto. Mislim da treba prvo da vidimo da je prvi jedan vraćen ovde u Prištini il tako dalje ili da počne obnova. ma porušenih, nisu samo oduzeti, ima u Obiliću porušeni u centru da se postavi temelj da to vlasti lokalne urade jedan pozitivni primerak da bi sutra mogli da izađemo pred svetom jer međunarodna zajednica će nas vrednovati po tome koliko smo spremni na neke konkretne stvari. Njima su puna usta povratka, međutim moraju da ponude sredstva ali ta sredstva, moraju biti raspoređena ne da idu u pravcu jedne zajednice a ti druga da budu zapostavljeni. Ako se sredstva za povratak od međunarodne zajednice obezbeđuju, ona moraju biti obezbeđena za sva raseljena lica. U ovom trenutku možda ima najviše raseljenih Srba ali ima i Albanaca raselenih iz delova

koji nisu ovde na Kosovu gde albanski su meštani ima i Bošnjaka , Turaka, Gorana i td. Oni se ne nalaze na tom prostoru i svakoj zajednici treba nuditi sredstva, da međunarodna zajednica mora biti obezbeđena za sva raseljena lica. U ovom trenutku možda najviše ima raseljenih Srba, ali ima i Albanaca raseljenih iz delova koja nisu ovde na Kosovu, ali pripadaju nekom delu Kosova. Ima i bošnjaka i Turaka, Gorana koji se ne nalaze na tom prostoru i svakoj zajednici treba ponuditi sredstva. Mora međunarodna zajednica da sve posmatra na Kosovu podjednako i kada su u pitanju dobre stvari i loše stvari. Ne možemo praviti privilegije, odnosno praviti diskriminaciju. Poonekad se pravi diskriminacija možda i pozitivna, ali želimo da ona bude pozitivna opet podjednako za sve inače ćemo podržati ovu rezoluciju, jer jako ovakve stvari ne bi podržavali onda ne znam za što smo ovde u Parlamentu. Hvala.

### **NEXHAT DACI**

Ju faleminderit, më lejoni pas të gjitha këtyre diskutimeve të bej këtë propozim Për votim do të jetë mbi të drejtat e komuniteteve dhe pjesa tjetër propozimi i Qeverisë në propozimet që mund të inkurpohen në atë dokument të theksuara nga deputeti Sabri Hamiti, të përkrahura nga Ramush Haradinaj dhe shumë të tjerë dmth. me qëllim të ngritjes së cilësisë së dokumentit, Ju falemnderoj për konstruktivitet të theksuar, për kontribut të mjaftueshëm, dhe për gatishmëri që Parlamenti i Kosovës është i gatshëm dhe i aftë që të debatojë për të gjitha çështjet e Kosovës dhe të Kosovarëve, do të thotë do të jetë një pako, votohet dokumenti dhe ju lutem votohet për propozimin që e dhashë para pauze do të thotë pjesë shoqëruese e cila e obligon zyrën e administratorit Shtajner dhe të kryeministrit që ta vënë në veto jetën dhe vetë vendimin e Parlamentit, prandaj kush është për këtë propozim. Pyes deputetët a ka ndonjë deputet që ka mendim tjetër që është kundër, asnjë , kundër, Ju faleminderit në mbledhjen e ardhshme të seancës plenare.